LIGJ
Nr.7590, datë 16.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7545, DATË 6.1.1992 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT E PERSONAVE FIZIKË NË SEKTORËT PRIVATË TË TREGTISË, ARTIZANATIT E SHËRBIMEVE TË TJERA"

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7545, datë 6.1.1992, neni 2 ndryshohet si vijon:

"Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse, dhe derdhen në buxhetin e shtetit".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja "a" dhe "b" bashkohen dhe ndryshohen si vijon:

a) Tregtarët që shesin prodhime të përpunuara vetë, mallra konsumi industrial e ushqimor si dhe produkte të tjera të gatshme, 6 për qind të arkëtimeve nga shitja e këtyre mallrave".

- Shkronja "c" bëhet "b" dhe ndryshohet si vijon:

"Artizanët e shërbimeve të tjera publike 4 për qind të të arshurave të realizuara".

- Shkronja "ç" bëhet "c" dhe ndryshohet si vijon:

"Avokatët, mjekët, veterinerët e persona të tjerë fizikë që ushtrojnë profesione të ngjashme me to, 10 për qind të të ardhurave të realizuara".

- Shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç" Traktoristët, kombajnerët etj. që kryejnë shërbime bujqësore, transporti etj.

- Për traktorët me zinxhirë 2 për qind të të ardhurave të realizuara.
- Për traktorët me goma 4 për qind të të ardhurave të realizuara.
- Për autokombajnat 5 për qind të të ardhurave të realizuara.
- Për makineritë e tjera bujqësore 2 për qind të të ardhurave të realizuara.
- Në fund të këtij neni shtohet shkronja "d" dhe "dh" me këtë përmbajtje:

"d" Personat që organizojnë kurse të ndryshme, 10 për qind të të ardhurave të realizuara.

"dh" Për motoskafe, trape dhe mjete të tjera lundrimi ujor, që përdoren për transport udhëtarësh e mallrash 6 për qind të të ardhurave të realizuara.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë fjala "tarifë" zëvendësohet me fjalën "kuotë".

- shkronja "a" bashkohet me shkronjën "b" dhe ndryshohet si vijon:

"a" Tregtarët që shesin prodhime mishi, sheqeri, brumi, mallra konsumi ushqimor dhe mallra të tjerë industrialë, 9000 lekë.

Shkronja "c" bëhet "b" dhe ndryshohet si vijon:

"Për shërbimet në transport 6 për qind të të ardhurave të realizuara, por jo më pak se:

- 12000 lekë në vit për automjetet deri në 5 vende.
- 25000 lekë në vit për automjetet deri në 10 vende.
- 60000 lekë në vit për automjetet deri në 25 vende.

- 70000 lekë në vit për automjetet deri në 40 vende.
- 80000 lekë në vit për automjetet mbi 40 vende".
- Për shërbimet në transportin brenda rrethit sipas nënndarjeve të mësipërme, bëhet një zbritje 20 për qind e tatimit.
- Shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:
"c" Personat fizikë që kryejnë shërbime në transportin ujor:
- Për varka në dispozicion të pushuesve 4000 lekë.
- Shkronja "d" ndryshohet si vijon:
Personat që kryejnë riparime e shërbime të artikujve elektroshtëpiakë, 9000 lekë".
- Pas shkronjës "e" shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:
"f" Për veprimtari të tjera ambulante që nuk përmenden në shkronjat e mësipërme, 4000 lekë".

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon: "Tatimi vjetor sipas neneve 3 dhe 4 llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të rretheve brenda muajit janar për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi", dhe verifikimit të bërë nga punonjësit e organeve tatimore.

Neni 5

Në nenin 7 fjalia e dytë, ndryshohet si vijon:
"Deklarata vjetore për të ardhurat e realizuara i jepet organeve tatimore brenda datës 15 janar të çdo viti për vitin paraardhës, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë".

Neni 6

Në nenin 8 shkronja "c" ndryshohet si vijon:
"c". Mosparaqitja e deklaratës për të ardhurat e realizuara.
Po në këtë nen shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:
"Mosderdhja në afatin e caktuar e tatimit mbi të ardhurat".

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si vijon: "Shkeljet e parashikuara në nenin 8 të këtij ligji kur nuk përnëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen:
- shkeljet e parashikuara në shkronjën "a" me gjobë 1000 deri në 4000 lekë;
- shkeljet e parashikuara në shkronjën "b" me gjobë 2000 deri në 5000 lekë;
- shkeljet e parashikuara në shkronjën "c" me gjobë 1000 deri në 4000 lekë;
- shkeljet e parashikuara në shkronjën "ç" me gjobë 1000 deri në 2000 lekë.
Në çdo rast tatimi nxirret 100 për qind.

Neni 8

Në nenin 10, në paragrafin e parë para fjalës "rrethe" shtohen fjalët "komuna, bashki e" dhe pas fjalës "Financave" shtohen fjalët "dhe e Ekonomisë".
Në paragrafin e dytë fjalët "te përgjegjësi i seksionit të financës" zëvendësohen me fjalët "te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki ose te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Neni 9

Në nenin 11, pas fjalës "Financave" shtohen fjalët "dhe e Ekonomisë".

Neni 10

Neni 13 shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.258, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.